



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.14, datë 28 .02. 2013

P Ë R

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 3, DATË 30.03.2009 “MBI CAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE NË SHËRBIMIN TAKSI TË QYTETIT TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 85 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); shkronjën “d”, pika 3/1 të nenit 10 dhe shkronjën “k” të nenit 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); kreun II.4, të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 për “Transportet Rrugore” (i ndryshuar); në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave nr.1726/3, datë 21.04.2008, për “Caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi”, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.3, datë 30.03.2009 “Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi të qytetit të Tiranës”, përsa i përket tarifave të mjeteve të shërbimit taksi (4+1 vende), si më poshtë:

Për mjetet e shërbimit taksi (4+1 vende)

ZONA E TARIFËS	DISTANCA PËR ZONAT E TARIFAVE (Km)	TARIFA Lek/km	TARIFA lek/min
Tarifa fillestare	1.5 km e para	250 lek/1.5 km	Nuk aplikohet
Zona A	5 km e tjera pas 1.5 km të para	100 lek/km	25 lek/min
Zona B	10 km e tjera pas 1.5 km të para +5 km	85 lek/km	21.25 lek/min
Zona C	Mbi 16.5 km	80 lek/km	20 lek/min

Tarifa për ditët e pushimit, festave zyrtare

ZONA E TARIFËS	DISTANCA PËR ZONAT E TARIFAVE (Km)	TARIFA Lek/km	TARIFA lek/min
Tarifa fillestare	1.5 km e para	300 lek/1.5 km	Nuk aplikohet
Zona A	5 km e tjera pas 1.5 km të para	120 lek/km	25 lek/min
Zona B	10 km e tjera pas 1.5 km të para +5 km	95 lek/km	21.25 lek/min
Zona C	Mbi 16.5 km	80 lek/km	20 lek/min

Tarifa për udhëtimin natën

ZONA E TARIFËS	DISTANCA PËR ZONAT E TARIFAVE (Km)	TARIFA Lek/km	TARIFA lek/min
Tarifa fillestare	1.5 km e para	300 lek/1.5 km	Nuk aplikohet
Zona A	5 km e tjera pas 1.5 km të para	120 lek/km	25 lek/min
Zona B	10 km e tjera pas 1.5 km të para +5 km	95 lek/km	21.25 lek/min
Zona C	Mbi 16.5 km	80 lek/km	20 lek/min

2. Ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë dhe Agjensia për Mbrojtjen e Konsumatorit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI